

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2148 / Prot.
11

Tiranë, më 03 / 10 /2025

V E N D I M

Nr. 100, datë 03 . 10 . 2025

PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
DHE PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 38, 46 dhe 61; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; Statutit të UMT-së, nenet 5, 26 dhe 75, si dhe Relacionin nr. 2187, prot., datë 02.10.2025, Senati Akademik, pasi shqyrtoi dhe diskutoi këtë Relacion, në mbledhjen e datës 03.10.2025,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm dhe Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, bëhen këto shtesa:

- 1.1 Në nenin 15, në fund të pikës 5 shtohen 2 (dy) fjali me këtë përmbajtje:

Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë, në të paktën 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.

- 1.2 Në nenin 17, pika 6, në fund të shkronjës i) shtohen 2 (dy) fjali me këtë përmbajtje:

Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë, në të paktën 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.

1.3 Në nenin 19, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5. Aplikantët për fitimin e titujve akademikë “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” duhet të kenë formim universitar në një nga programet e studimit, si ato që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ose të jenë personel akademik me kohë të plotë në UMT, pavarësisht programit të studimit që kanë përfunduar.

2. Vendimi i përcillet për njohje dhe zbatim KPPPA dhe njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI
PROF. DR. XHELADIN DRACINI

